

**MANUAL PËRDORIMI PËR BKT SMART-4C iOS DHE ANDROID PËR
BIZNESET**

PËRMBAJTJA

I. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR PËRDORIMIN E BKT SMART	4
1. INSTALIMI I BKT SMART	4
2. INFORMACION PA HYRË NË BKT SMART	5
3. REGJISTRIMI NË BKT SMART	7
4. HYRJA NË BKT SMART	8
4.1 Hyrja me Numër Klienti/Numër Personal dhe ID kompanisë/NIPT	8
4.2 Hyrja me të dhënat Biometrike	9
4.3 Hyrja kur keni harruar fjalëkalimin	9
4.3.1 Karta Juaj BKT	9
4.3.2 Kodi Unik	10
II. MENU	10
III. PROFILI & CILËSIMET	10
1. FOTO PROFILI	10
2. INFORMACIONI I PROFILIT	10
3. TË DREJTAT	10
4. SIGURIA.....	11
5. TERMAT & KUSHTET	12
IV. NJOFTIMET & KËRKESAT	12
1. KËRKESAT E MIA	12
2. NJOFTIMET.....	13
V. FINANCAT E MIA.....	13
1. PËRMBLEDHJA	13
1.1 Llogaritë	13
1.1.1 Detajet	13
1.1.2 Pasqyra e llogarisë	13
1.1.3 Cilësimet	14
1.2 Hapja e llogarisë.....	14
1.3 Karta e Kreditit.....	14
1.3.1 Limiti në internet.....	15
1.3.2 Pasqyrat.....	15
1.3.3 Paguaj Kartën e Kreditit	15
1.3.4 Detajet e kartës së kreditit	15
1.3.5 Transaksionet e fundit.....	16
1.4 Hapja e depozitës	16
2. HISTORIKU	17
VI. PAGESAT & TRANSFERTAT	17
1. TRANSFERTAT	18
1.1 Midis llogarive të mia	18
1.2 Brenda BKT.....	19
1.3 Brenda Vendit	19
1.4 Jashtë vendit, Transferta ndërkombëtare	20
1.5 Transfertat e mia Ndërkombëtare	22
1.6 Në Fond Pensioni	23
1.7 E-Fatura	23
2. PAGESAT	24
2.1 Rimbushje celulari	24
2.2 Dogana	25
2.3 Gjobat e trafikut	25
2.4 Pagesë karte	26
2.5 Taksat.....	27

2.5.1	<i>Thesari</i>	27
2.5.2	<i>Tatimet</i>	27
2.6	<i>Pagesa e-Albania</i>	27
3.	FATURA.....	28
3.1	<i>Pagesë faturash</i>	28
3.2	<i>Faturat e autorizuara</i>	29
3.3	<i>Pagesë fature me Barkod</i>	29
4.	KËMBËM VALUTE	30
4.1	KËMBËMI VALUTOR.....	30
4.1.1	<i>Bli valutë të huaj</i>	30
4.1.2	<i>Shit valutë të huaj</i>	30
4.1.3	<i>Konverto në valutë të huaj</i>	31
4.2	KËRKSAT E MIA	31
5.	MIRATËME NË PRITJE.....	31
6.	PA KARTË	31
6.1	<i>Depozitim me Kod Unik</i>	32
6.2	<i>Depozitimet e mia pa kartë</i>	32
VII.	PRODUKTET DHE SHËRBIMET	32
1.	PRODUKTET.....	32
1.1	HAPNI NJË LLOGARI RRJEDHËSE	32
1.2	HAPNI NJË DEPOZITË.....	33
1.3	PRANO PAGESAT E FATURAVE TATIMORE DHE SMART POS.....	33
2.	SHËRBIMET	35
VIII.	DALJA NGA BKT SMART	36
IX.	PROÇESI I MBYLLJES SË BKT SMART	36
X.	PROÇESI I RIAKTIVIZIMIT TË PËRDORIMIT TË BKT SMART	36

I. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR PËRDORIMIN E BKT SMART

Shërbimi i BKT Smart mund të përdoret nëse:

1. Dini numrin e klientit (një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie në BKT) pse numrin personal të kartës së identitetit.
2. Keni firmosur KSHBB (Kontrata e Shërbimeve Bankare për Biznesin, e cila firmoset në degë) si dhe keni plotësuar dhe nënshkruar dokumentacionin pranë degëve të BKT-së, për t'u regjistruar në shërbimin Dega Internet.
3. Keni një kartë aktive Debiti ose Krediti (Individuale ose Biznesi) të lëshuar nga BKT.
4. Keni një numër celular të vlefshëm të regjistruar në bankë.
5. Keni një Smart Phone, nëse sistemi operativ është Android versioni duhet të jetë mbi 15
6. Telefoni është i lidhur me një linjë interneti gjatë kryerjes së të gjitha veprimeve.




Shënim: Nëse keni një kartë të BKT dhe jeni i klasifikuar si Person Fizik ju mund të regjistroheni direkt në BKT Smart/ Dega Internet pa patur nevojë të paraqiteni në degë për firmosjen e dokumentacionit.

1. INSTALIMI I BKT SMART

Shënim: Për çdo përditësim të aplikacionit BKT Smart, do ju shfaqet një njoftim (popup) në pajisjen tuaj, ku do ju kërkohet instalimi i versionit më të fundit (i detyrueshëm) për të vijuar me përdorimin e aplikacionit.

Për të instaluar BKT Smart në celularin tuaj duhet të ndiqen hapat e mëposhtme:

1. Sigurohuni të keni numrin e klientit të subjektit/ NIPT ose numrin e klientit/ numrin personal të kartës suaj të identitetit (dhe fjalëkalimin nëse jeni regjistruar më parë në kanalën e Degës Internet).
2. Sigurohuni që numri i celularit të jetë numri që është regjistruar në BKT.
3. Duhet lidhja me një linjë interneti të telefonit celular ose Wi-Fi dhe sigurohuni të keni hapësirë të mjaftueshme në memorien e celularit.
4. Aplikacioni mund të shkarkohet nga Play Store (Android) ose App Store (iOS), duke kërkuar "BKT Smart" – kërkonte logon:
5. Lexoni me kujdes Kushtet e aplikacionit dhe nëse jeni dakord klikoni butonin "Allow", për vendodhjen:
6. Nëse doni të merrni njoftime nga BKT Smart klikoni butonin "Allow", për njoftimet:



- Automatiksht në telefonin celular do të krijohet ikona e aplikacionit dhe duke klikuar mbi të mund të hysh më pas në aplikacion.

2. INFORMACION PA HYRË NË BKT SMART

Në momentin që ju shkarkoni aplikacionin BKT Smart do të njiheni me Termat & Kushtet e Shërbimeve Bankare Elektronike. Për të vijuar me përdorimin e aplikacionit BKT Smart, ju fillimisht duhet të aprovonit këto terma dhe kushte, duke klikuar në opsionin "Aprovo".

Duke **klikuar** mbi ikonën përkatëse në ekranin e hyrjes (pre-login) mund të kryeni veprimet e mëposhtme pa qenë e nevojshme të logoheni në BKT Smart:

Shënim! Menuja Soft PIN dhe Pa kartë mund të përdoren vetëm nëse ju keni autorizuar pajisjen tuaj si të besuar.



- Fushatat/ Paketat/ Çmimet aktuale të BKT - Fushatat aktuale që ju shfaqen në BKT SMART
- Soft PIN** - Nëse ju keni të aktivizuar opsionin Trusted Device (Pajisja e besuar), këtu do të mund të merrni, në çdo moment, kodin Soft PIN të gjeneruar.
- Pa Kartë** - Nëse keni aktivizuar Trusted Device (Pajisja e besuar), këtu mund të gjeneroni kodin Unik për depozitim me kod unik
- Këmbimi valutor
 - Në Monedhën Lek (ALL – Albanian Lek), si dhe në monedhat e tjera
 - Llogaritësi i kursit të këmbimit



- Bileta në rradhë - për rezervimin e rradhës për në degët e BKT (për këtë menu kërkohet aktivizimi i Vendodhjes/ Location)
 - nëse klikoni mbi buton, do të shfaqet lista e biletave që ju keni
 - klikoni butonin "Merrni Biletë" për të marrë një biletë të re
 - zgjidhni degën që do të kryeni veprime nga lista
 - më pas klikoni mbi shërbimin e kërkuar në degë:
 - Arkë (për veprime me para cash)
 - Shërbim me klientin (për veprime me llogaritë)
 - Kredi (për informacion mbi produktet e kredisë)
 - Do të gjenerohet bileta e rradhës me informacionet përkatëse, ju mund të klikoni butonin "Merrni Drejtim" për të parë vendodhjen e degës në hartë dhe rrugën që duhet të ndiqni për të shkuar atje ose mund të klikoni butonin "Kthehu te Hyrja".




- Llogaritësi i Depozitës/ Llogaritësi i Kredisë, klikoni mbi një nga këto opsione për të marrë informacion mbi produktin e kërkuar.



- Termt & Kushtet - Kushtet e Punës me të cilat operon BKT
- Na kontaktoni
 - Shërbimi i klientit (Contact Center)
 - Faqet zyrtare të BKT në rrjetet sociale.
- ATM më e afërt (për këtë menu nevojitet aktivizimi i Vendndodhjes/ Location) - Këtu gjeni vendndodhjet e ATM-ve më të afërta. Navigoni mbi hartë për të gjetur vendndodhjet e


ATM-ve të afërta me vendndodhjen tuaj ose klikoni mbi listë për të parë të gjitha ATM-të më të afërta sëbashku me distancën e tyre.



3. REGJISTRIMI NË BKT SMART


Pasi të keni instaluar aplikacionin e BKT Smart, klikoni mbi logon e tij dhe ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Hapi i parë – Klikoni butonin “Klient/Përdorues i ri”
2. Hapi i dytë – Zgjidhni Jam klient i BKT
3. Hapi i tretë – Vendosni Numrin e klientit ose Numrin personal
4. Hapi i katërt – Vendosni ID e kompanisë ose NIPT
5. Hapi i pestë – Klikoni mbi butonin “Klikoni Klient/Përdorues i ri”



6. Në faqen pasardhëse ju mund të zgjidhni të regjistroheni me kartën tuaj në BKT ose nëse nuk keni një kartë të lëshuar nga BKT duhet të paraqiteni pranë degës më të afërt të BKT për të aplikuar për kod unik dhe më pas zgjidhni opsionin me kodin unik.

7. Nëse zgjidhni regjistrimin me kartë hapat që duhet të ndiqni janë:

- Zgjidhni tipin e kartës (nëse karta juaj ka këtë logo , tipi i kartës është “contactless”);
- Vendosni 6 numrat e fundit të kartës që keni zgjedhur dhe më pas klikoni VAZHDO;

- Vendosni PIN-in e kartës që keni zgjedhur dhe më pas klikoni VAZHDO.
8. Pasi të kaloni me sukses hapat e mësipërme, në numrin e telefonit të regjistruar në sistemin e BKT (i cili shfaqet i koduar) do t'ju dërgohet një SMS me kodin që do të vendoset në faqen e FNP (Fjalëkalim me një Përdorim). FNP do t'ju dërgohet sa herë që të hyni në BKT Smart dhe ka një afat prej 2 minuta. Vendosni kodin FNP dhe klikoni VAZHDO.
 9. Krijoni një fjalëkalim sipas kriterëve të mëposhtme:
 - Fjalëkalimi duhet të jetë 6-shifror.
 - Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të përsëritur (p.sh. 111111, 111222) dhe as numra të njëpasnjëshëm (p.sh. 123456)
 - Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV).

4. HYRJA NË BKT SMART

Pasi të keni kryer procesin e regjistrimit, mund të hyni në BKT Smart nëpërmjet Numrit të Klientit /Numrit Personal të kartës së identitetit dhe ID së kompanisë/NIPT.


4.1 Hyrja me Numër Klienti/Numër Personal dhe ID kompanisë/NIPT

Për të hyrë në BKT Smart duhet:

- a. Numri i klientit (një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie në BKT) /numri personal i kartës suaj të identitetit (numri që fillon dhe përfundon me shkronjë);
- b. (ID e Kompanisë, një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie biznesi në BKT) ose NIPT I subjektit që po hyn në BKT Smart;
- c. Fjalëkalimi (i krijuar gjatë hapave të regjistrimit ose i krijuar më parë në Degën Internet);

Nëse jeni regjistruar më parë në Degën Internet ju mund të hyni në BKT Smart me të njëjtin fjalëkalim.

Më pas klikoni butonin "Hyr" për të kaluar në hapin pasardhës:



4.2 Hyrja me të dhënat Biometrike

Mënyrë tjetër për të hyrë në BKT Smart, është nëpërmjet të dhënave biometrike¹ cilat janë regjistruar më parë në pajisjen tuaj. Të dhënat biometrike nënkuptojnë gjurmët e gishtave ose skanimin e fytyrës për aparatet celulare që i ofrojnë këto tipe identifikimi. Nëse aparati celular e ofron si hap sigurie shenjën e gishtave/ fytyrës suaj, atëherë ju mund t'i aktivizoni edhe për të hyrë në BKT Smart.

Aktivizimi i të dhënave biometrike bëhet vetëm pasi të keni hyrë një herë në BKT Smart me numër klienti ose numrin personal të kartës së identitetit dhe të keni aktivizuar këtë shërbim nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- a. Hyni nëpërmjet Numrit të Klientit/ Numrit Personal, ID Kompanie/ NIPT dhe Fjalëkalimit tuaj
- b. Vendosni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit
- c. Klikoni te profili juaj
- d. Klikoni butonin e aktivizimit përbri butonit "Identifikohu me të dhënat biometrike"
- e. Vendosni fjalëkalimin tuaj dhe klikoni "Verifikoni"
- f. Skanoni gjurmët e gishtave/ fytyrën tuaj
- g. Në fund të procesit do të merrni mesazhin e konfirmimit mbi aktivizimin e këtij opsioni

Pasi të keni kaluar hapin e aktivizimit, në faqen e parë klikoni menjëherë butonin "Hyrje" dhe:

- a. Klikoni mbi butonin "Logohu me të dhëna biometrike"
- b. Skanoni shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj,
- c. Vendosni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit,

Nëse ju keni regjistruar edhe pajisjen tuaj për opsionin Smart FNP², përveç të dhënave biometrike, duke klikuar butonin "Hyrje" ju mund të hyni direkt në aplikacion duke skanuar vetëm shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj. Pra:

- a. Klikoni butonin "Hyr"
- b. Klikoni mbi butonin "Logohu me të dhëna biometrike"
- c. Skanoni shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj
- d. Automatikisht do të validohet FNP dhe do të hyni direkt në aplikacion


4.3 Hyrja kur keni harruar fjalëkalimin

Në rast se keni harruar fjalëkalimin, ju mund të hyni në BKT Smart duke krijuar një fjalëkalim të ri duke klikuar opsionin "Kam harruar fjalëkalimin" dhe nëpërmjet njërës nga 2 mënyrat:

- a. Karta Juaj BKT
- b. Kodi Unik

4.3.1 Karta Juaj BKT

Nëse keni një kartë debiti/ krediti të BKT-së klikoni "Karta juaj BKT" dhe ndiqni hapat si në vijim:

- a. Zgjidhni tipin e kartës (nëse karta juaj ka këtë logo , tipi i kartës është "contactless")
- b. Vendosni 6 numrat e fundit të kartës që keni zgjedhur dhe më pas Klikoni VAZHDO
- c. Vendosni PIN-in e kartës që keni zgjedhur dhe më pas Klikoni VAZHDO
- d. Vendosni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit
- e. Krijoni një fjalëkalim sipas kriterëve të mëposhtme:

¹Aktivizimin e të dhënave biometrike e gjeni në Menunë [Profili](#)

²Aktivizimin e Smart FNP e gjeni në Menunë [Profili](#)

- Fjalëkalimi duhet të jetë 6-shifror.
 - Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të përsëritur (p.sh.111111, 111222) dhe as numra të njëpasnjëshëm (p.sh.123456).
 - Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV).
 - Fjalëkalimi i ri nuk duhet të jetë i njëjtë me fjalëkalimet e mëparshme.
- f. Përsërisni fjalëkalimin dhe klikoni VAZHDO

4.3.2 Kodi Unik

Nëse nuk keni një kartë nga BKT, paraqituni pranë degës më të afërt të BKT për të aplikuar për një Kod Unik dhe më pas zgjidhni opsionin me "Kod Unik" dhe ndiqni hapat si në vijim:

- a. Vendosni Kodin Unik të gjeneruar me praninë dhe konfirmimin tuaj pranë degëve të BKT-së dhe klikoni VAZHDO
- b. Vendosni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit
- c. Krijoni një fjalëkalim sipas kriterëve të mëposhtme:
 - Fjalëkalimi duhet të jetë 6-shifror.
 - Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të përsëritur (p.sh.111111, 111222) dhe as numra të njëpasnjëshëm (p.sh. 123456).
 - Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV);
 - Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me fjalëkalimet e mëparshme.
- d. Përsërisni fjalëkalimin dhe klikoni VAZHDO

II. MENU

Pasi të keni kaluar hapat me sukses, shfaqet faqja kryesore e BKT Smart, nga ku mund të shihni të gjitha produktet dhe shërbimet që ofrohen nga BKT Smart:

1. Në ikonën e avatarit do të gjeni informacion mbi Profilin tuaj
2. Në ikonën e mesazheve do të gjeni Njoftimet & kërkesat
3. Në faqen e parë hyrëse do të gjeni menunë "Financat e mia" e cila përmban:
 - Përmbledhja;
 - Veprimet;
4. Në faqen e dytë do të gjeni Pagesat & Transfertat dhe
5. Produktet dhe Shërbimet

III. PROFILI & CILËSIMET

Nëse klikoni tek ikona në të majtë lart do t'ju shfaqet Menu-ja **Profili & Cilësimet**:

1. Foto Profili

Këtu mund të vendosni një foto profili të cilën mund ta përdorni në detajet e veprimit. Për të vendosur një foto profili mjafton të klikoni mbi imazhin që shfaqet në fillim të menu-së Profili & Cilësimet dhe të zgjidhni një nga mënyrat e mëposhtme:

- Bëj Foto – duke përdorur kamerën ose Zgjidhni nga galeria – e telefonit tuaj celular

Për të përdorur foton në detajet e veprimit dhe për tu shfaqur te klientët të cilët ju kanë regjistruar ju si kontakt me numër telefoni ose me numër llogarie në BKT Smart mjafton të klikoni "Përdorni foton në detajet e veprimeve".

2. Informacioni i Profilit

Këtu mund të shikoni adresën e postës elektronike si dhe adresën e vendbanimit.

- Numrin e klientit dhe Adresën;
- Nr e telefonit dhe E-mail;

3. Të Drejtat

Këtu mund të shikoni të Drejtat e përdoruesit:

- Të drejtat Monetare apo Jo monetare;
- Autorizuesi, Kontrollues, Monitorimi;

4. Siguria

Këtu mund të zgjidhni nëse doni të aktivizoni opsionin:

- **Më Kujto** që ndodhet në faqen hyrëse të BKT Smart dhe ju lejon të ruani numrin e klientit/ ID e kompanisë dhe të vendosni vetëm fjalëkalimin gjatë hyrjes në aplikacion.
- **Identifikimin me të dhëna biometrike** (gjurmat e gishtave ose njohja e fytyrës suaj) të ruajtuara më parë në këtë pajisje. Nëse aktivizoni identifikimin me të dhëna biometrike, do të aktivizohet automatikisht edhe opsioni "Më kujto".
- **Pajisjet e autorizuara (Trusted Device)** – është një mundësi për përdoruesit që të autorizojnë pajisjet e tyre si të besuara për të mundësuar një akses më të shpejtë dhe më të sigurt në aplikacionin BKT Smart.

Numri maksimal i pajisjeve të autorizuara për një përdorues është **2 pajisje**. Ju mund ta aktivizoni pajisjen tuaj si të autorizuar nëpërmjet dy mënyrave kryesore:

- **Përmes pop-up automatik:** Kur ju logoheni në aplikacionin BKT Smart për herë të tretë rradhazi në të njëjtën pajisje, do t'ju shfaqet automatikisht një dritare për mundësinë e aktivizimit të pajisjes si të autorizuar. Mjafton që ju të aprovoni këtë kërkesë për të përfunduar procesin e autorizimit.
- **Përmes verifikimit me NFC:** Ju mund të autorizoni pajisjen tuaj duke bërë verifikimin me dokument identifikimi tek menuja Profili & Cilësimet / Pajisjet e autorizuara.
 - o Klikoni AUTORIZO për të filluar procesin e autorizimit.
 - o Vendosni Fjalëkalimin dhe klikoni VERIFIKO
 - o Lexoni me kujdes udhëzimet mbi mënyrën e verifikimit të dokumentit kartë identiteti. Klikoni FILLO SKANIMIN.
 - o Vendosni dokumentin tuaj të identifikimit pas telefonit tuaj. Sigurohuni që të hiqni kasën mbrojtëse të telefonit paraprakisht.
 - o Klikoni PRANOJ nëse dëshironi të logoheni me biometrikë.

Aktivizimi i këtij funksionaliteti aktivizon automatikisht opsionet "Më kujto", Smart FNP dhe Soft PIN.

Detajet e pajisjeve të autorizuara: Për të parë listën e pajisjeve të autorizuara, klikoni Profili & Cilësimet dhe zgjidh menunë Pajisjet e autorizuara. Do të shfaqet lista e pajisjeve të autorizuara së bashku me detaje si:

- o Emri i pajisjes së autorizuar
- o Lloji i pajisjes
- o Koha e autorizimit
- o Data e veprimit të fundit
- o Historiku i aktiviteteve

Për të parë një përmbledhje më të detajuar të aktiviteteve klikoni SHFAQ AKTIVITETIN

Do të shfaqen detajet:

- o Veprimet e kryera nga pajisja dhe Koha e çdo veprimi
- o Vendndodhjen nga ku janë kryer veprimet (nëse keni dhënë akses për të marrë vendndodhjen në atë pajisje).

Nëse dëshironi të hiqni autorizimin e pajisjeve, klikoni mbi Ç'aktivizo tek pajisja specifike të cilës dëshironi të hiqni autorizimin.

- **Soft PIN** - është një zgjidhje gjithpërfshirëse e identifikimit me shumë faktorë që ofron metodën e validimit të aparatit telefonik. Me autorizimin e pajisjes, klienti regjistron pajisjen për të njohur automatikisht fjalëkalimin (PIN-in) duke eliminuar vendosjen manuale të FNP-së. SoftPIN redukton periudhën kohore të shpenzuar për procesin e identifikimit. Gjithashtu Soft Pin mund të përdoret për një logim më të thjeshtë në degën internet. Në menunë "**Soft PIN**" – ju mund të merrni në çdo moment kodin Soft PIN ose të gjeneroni një kod të ri Soft PIN.

- **Identifikohu duke përdorur Smart FNP** - këtu mund të zgjidhni nëse doni të aktivizoni regjistrimin e pajisjes tuaj, nëse doni që të njihet FNP (fjalëkalim me një përdorim) automatikisht gjatë hyrjes në BKT Smart. Nëse aktivizoni këtë opsion, në momentin e hyrjes në BKT Smart nuk do të jetë e nevojshme që të vendosni manualisht FNP, por ai do të njihet automatikisht nga aplikacioni.

Nëse ndryshoni aparatin tuaj celular, duhet të riaktivizoni këtë opsion.

Nëse keni aktivizuar opsionin e njohjes me të dhënat biometrike (gjurmët e gishtave/ fytyrën tuaj) dhe Smart FNP, në momentin e hyrjes ju mund të skanoni vetëm gjurmën e gishtave/ fytyrën tuaj dhe më pas do të drejtoheni direkt në brendësi të BKT Smart duke shmangur hapin e vendosjes:

- Së numrit të klientit/ numrit personal të kartës së identitetit dhe ID e kompanisë/ NIPT,
- Fjalëkalimit dhe FNP
- **Ndrysho fjalëkalimin** - këtu do të mund të ndryshoni fjalëkalimin tuaj ekzistues me një fjalëkalim të ri duke ndjekur hapat e mëposhtme:
- Zgjidhni kartën që keni në BKT (nëse keni më shumë se 1, rrëshkisni majtas/ djathtas për të zgjedhur kartën) dhe Vendosni kodin PIN të kartës së zgjedhur
- Shkruani fjalëkalimin ekzistues në fushën e parë dhe në dy fushat e rradhës, fjalëkalimin e ri
- **Nëse keni të autorizuar pajisjen tuaj**, shkruani në dy fushat e dhëna, fjalëkalimin e ri:
 - o Fjalëkalimi duhet të jetë 6-shifror
 - o Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të përsëritur (p.sh.111111, 111222) dhe as numra të njëpasnjëshëm (p.sh.123456).
 - o Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV)
 - o Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me fjalëkalimet e mëparshme.

5. Termat & Kushtet

Në këtë menu mund të lexoni të gjitha termat dhe kushtet me të cilat operon BKT për klientët:

1. Individ
2. Biznes


IV. NJOFTIMET & KËRKESAT

Nëse klikoni tek ikona në formë zarfi në të djathtë lart do t'ju shfaqet Menu-ja **Njoftimet & Kërkesat**:

1. Kërkesat e mia

Këtu mund të dërgoni një sugjerim ose ankesë.

1. Për të dërguar një kërkesë klikoni mbi "Kërkesat e mia", "Kërkesë e re",
2. Zgjidhni nëse doni të dërgoni një ankesë apo sugjerim.
3. Plotësoni detajet e ankesës apo sugjerimit dhe klikoni Vazhdo.
4. Ju do të merrni një mesazh për sugjerimet dhe ankesat tuaja nga BKT.



2. Njoftimet

Në këtë menu mund të shihni listën e njoftimeve që ju kanë dërguar në aparatit tuaj celular. Njoftimet do të dërgohen në aparatit celular ku klienti ka hyrë për herë të fundit në BKT Smart. Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** mund të shihni listën e njoftimeve të fundit.

V. FINANCAT E MIA

Në këtë menu do ju shfaqen llogaritë e subjektit tuaj dhe gjendja e disponueshme. Këtu ju mund të navigoni duke zgjedhur opsionin që doni të kryeni duke klikuar mbi

- Përmbledhja
- Veprimet

1. Përmbledhja

Në këtë faqe do të gjeni një përmbledhje të detajuar mbi balancën në llogarinë tuaj , si dhe llogaritë tuaja të listuara.

1. Llogaritë - këtu listohen të gjitha llogaritë tuaja aktive
2. Shto një llogari të re- këtu mund të regjistroni një llogari të re rrjedhëse.
3. Kartat e kreditit – këtu shfaqet karta juaj e kreditit
4. Nëse klikoni mbi një nga llogaritë tuaja do ju shfaqet gjendja juaj e disponueshme si dhe 3 nënmenu: Cilësimet, Detajet, Pasqyra.

1.1 Llogaritë

Nëse klikoni mbi një nga llogaritë tuaja, do ju shfaqen veprimet e kryera me këtë llogari, si dhe 3 nënmenu të tjera. Duke ndjekur hapat më poshtë ju do të keni mundësinë të kryeni këto veprime (Zgjidhni llogarinë tuaj dhe do ju shfaqen 3 nënmenu):

1. Detajet
2. Pasqyra
3. Cilësimet

1.1.1 Detajet

Këtu ju mund të shikoni detajet e llogarisë tuaj. Detajet që do ju shfaqen vijojnë si më poshtë:

- Emri i Subjektit
- Data e hapjes së llogarisë
- Kodi IBAN
- Numri i llogarisë
- Shuma e bllokuar

1.1.2 Pasqyra e llogarisë

Në këtë nënmenu mund të shikoni pasqyrën e llogarisë tuaj duke ndjekur hapat e mëposhtme:

- a. Zgjidhni datën e fillimit duke klikuar mbi ikonën e kalendarit, duke rrëshqitur majtas/ djathtas ose me shigjetën, zgjedhni muajin/ vitin dhe **Klikoni** Aplikoni
- b. Zgjidhni datën e përfundimit, **Klikoni** Aplikoni, **Klikoni** Konfirmo
- c. Më pas do ju shfaqet pasqyra e transaksioneve për periudhën e zgjedhur ku ju mund të zgjidhni ta regjistroni atë në aparatit tuaj celular ose ta ndani atë ne kanale të tjera nëpërmjet opsionit të Share.

1.1.3 Cilësimet


Këtu ju mund të zgjidhni të vendosni një logo në llogarinë tuaj dhe të vendosni një përshkrim:

- Zgjidhni logon e llogarisë duke klikuar në një mbi ikonat që ju shfaqen
- Klikoni** Ruaj dhe ikona do të regjistrohet si logo e llogarisë tuaj

Klikoni këtu për të vendosur logon një llogarie

Klikoni këtu për Detajet e llogarisë


Klikoni këtu për të gjeneruar Pasqyrën e llogarisë



1.2 Hapja e llogarisë

Për të shtuar një llogari të re rrjedhëse ndiqni hapat e mëposhtëm:

- **Shto një llogari të re rrjedhëse**

Klikoni mbi ikonën e plusit () për të shtuar një llogari dhe ju mund të hapni një llogari të re rrjedhëse në monedhat e mëposhtme:

- Lekë (ALL)
- Euro (EUR)
- Dollar Australian (AUD)
- Paund Britanik (GBP)
- Dollar Kanadez (CAD)
- Dollar Amerikan (USD)
- Franga Zviceriane (CHF)

- Pasi të keni zgjedhur monedhën që doni, Plotësoni Emrin e llogarisë
- Zgjidhni logon e llogarisë
- Konfirmoni llogarinë tuaj duke **klikuar** Konfirmo

Llogaria rrjedhëse është aktive që në momentin e hapjes kur Biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhesi i të dhëna dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Aprovime Në Pritje për të autorizuar hapjen e llogarisë.

1.3 Karta e Kreditit


Për të parë **informacionin mbi kartat tuaja** të kreditit në BKT, ndiq hapat e mëposhtëm: Duke rrëshqitur majtas/ djathas, përzgjidh kartën për të cilën kërkohet informacioni dhe do të shfaqet informacioni i mëposhtëm:

- Mbajtësin e kartës/ administratori (emër mbiemër)
- Tipin e kartës së kreditit dhe Numrin e kartës (për arsye sigurie shfaqet i koduar)
- Limitin e mbetur të kartës së kreditit
- Datën e prerjes së pasqyrës së llogarisë të fundit për kartën e kreditit
- Datën e fundit të pagesës për pasqyrën e fundit të llogarisë së kartës së kreditit
- Kryesore/ Dytësore (lloji i kartës), Limiti i kartës (limiti i aprovuar nga dega)
- Statusin e kartës (statusi i kartës së kreditit)
- Pasqyra e fundit e kartës së kreditit me shumën përkatëse (shuma totale dhe minimale)
- Data e fundit e pagesës për pasqyrën e fundit të kartës së kreditit

Gjithashtu, ju do të keni mundësi të përdorni një nga nënmenutë e kartës së kreditit si në vijim:

1. Limiti në internet
2. Pasqyrat
3. Paguaj kartën e kreditit
4. Blloko përkohësisht
5. Riaktivizo
6. Merr PIN të Ri
7. Transaksionet e fundit

1.3.1 Limiti në internet

Klikoni mbi këtë buton  për të aktivizuar ose ndryshuar përqindjen e limitit të kartës së kreditit për blerje në internet, nga 0-100% të limitit të kartës së kreditit.

Për të ndryshuar limitin për përdorim në internet ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Plotësoni manualisht ose zgjidhni një nga vlerat e limiti të shfaqura në listë nga (0-100%);
- Kliko Vazhdo nëse për të kaluar në faqen e konfirmimit;
- Në faqen konfirmuese verifiko edhe një herë të dhënat e veprimit
- Kliko Vazhdo për të kryer ose kthehu pas për anuluar kërkesën

Limiti i ndryshur nëpërmjet BKT Smart aktivizohet në moment nëse biznesi ka kërkuar që përdoruesi të jetë me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhesi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Aprovime Në Pritje për të autorizuar pagesën e Kartës së Kreditit.

1.3.2 Pasqyrat

- Klikoni mbi opsonin "Shikoni pasqyrat e mëparshme" për të marrë informacin mbi pasqyrat tuaja.
- Duke rrëshqitur poshtë/ lartë, zgjidhni pasqyrën për të cilën kërkon informacion
- Klikoni mbi pasqyrë dhe më pas do t'ju shfaqet lista e transaksioneve për pasqyrën e zgjedhur, duke rrëshqitur poshtë/ lartë mund të shihni transaksionet

1.3.3 Paguaj Kartën e Kreditit

Klikoni PAGUAJ për të kryer pagesën e kartës tuaj të kreditit dhe ndiqni hapat e mëposhtme:

- Klikoni mbi llogarinë dhe duke rrëshqitur poshtë/lart zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet pagesa e kartës së zgjedhur. Zgjidhni tipin e pagesës:
 - **Minimumi** – detyrimi minimal që duhet të paguhet brenda datës së fundit të pagesës (do të shfaqet automatikisht)
 - **E mbetur** – detyrimi total i kartës për muajin aktual (do të shfaqet automatikisht)
 - **Tjetër** – vendosni manualisht shumën që dëshironi të paguani
- Klikoni VAZHDO, Verifikoni të dhënat e pagesës dhe Klikoni KONFIRMO

1.3.4 Detajat e kartës së kreditit

Këtu mund të shikoni **informacionin mbi kartën e kreditit** në BKT, si dhe mund të zgjidhni nga opsionet:

- Blloko përkohësisht kartën e kreditit,
- Riaktivizo kartën e kreditit
- Merr Pin të ri për kartën e kreditit,

a. Blloko përkohësisht kartën e kreditit

Këtu mund të bllokoni përkohësisht kartën tuaj të kreditit. Zgjidhni kartën e kreditit që doni të bllokoni dhe klikoni Blloko Përkohësisht, në faqen konfirmuese klikoni KONFIRMO



b. Riaktivizo kartën e kreditit

Këtu mund të riaktivizoni kartën e kreditit. Zgjidhni nga lista e kartave të kreditit, kartën të cilën doni të aktivizoni dhe klikoni Riaktivizo, në faqen konfirmuese klikoni KONFIRMO

c. Merr PIN të ri për kartën e kreditit

Klikoni "Merr PIN të ri" dhe në faqen konfirmuese klikoni KONFIRMO. PIN-i do të ndryshohet dhe në numrin tuaj të telefonit që keni të regjistruar në bankë do të dërgohet një sms me informacionin e nevojshëm për të vazhduar me tej

Shënim: Fillimisht kryeni një veprim të çfarëdoshëm në ATM dhe më pas mund ta përdorni kartën tuaj kudo.

Shënim: Për këto shërbime do të kenë akses vetëm klientët biznes të cilët janë kartëmbajtës dhe njëkohësisht përdorues të BKT Smart.


1.3.5 Transaksionet e fundit



Nëse keni klikuar kartën e kreditit duke rrëshkitur poshtë do t'ju shfaqet lista e transaksioneve të cilat do ju shfaqen në nxjerrjen e pasqyrës së ardhshme të kartës së kreditit me detajet e mëposhtme:

- Data e veprimit (data kur është kryer transaksioni) dhe Shuma (shuma e transaksionit)
- Përshkrimi i veprimit (tregtari ku është kryer transaksioni)
- Statusi i veprimit (i përfunduar ose në pritje nëse transaksioni pritet të tërhiqet nga tregtari)

1.4 Hapja e depozitës

Këtu mund të hapni një depozitë duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

Duke klikuar në ikonën e plusit () ju mund të hapni një depozitë të re. Klikoni mbi opsionin përkatës dhe zgjidhni mënyrën e hapjes së depozitës:

- Nëpërmjet listës së produkteve të BKT (me periudha fikse)
- Nëpërmjet Datës së maturitetit që ju doni (minimumi i periudhës së hapjes është 40 ditë)
 - Nëse keni zgjedhur të hapni depozitë **sipas produkteve të BKT**
 - a. Rrëshqisni **poshtë/ lartë** dhe zgjidhni tipin e depozitës nga lista
 - b. Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën () zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma që do të investohet në depozitë
 - c. Vendosni shumën (minimumi 50,000.00 ALL ose 500 monedhë e huaj)
 - d. Interesi do të shfaqet automatikisht
 - e. Zgjidhni nëse doni që kjo depozitë të rinovohet automatikisht dhe më pas tipin e rinovimit (Principal ose Principal & Interes), **Klikoni** VAZHDO dhe në faqen konfirmuese **klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën
 - Nëse keni zgjedhur të hapni depozitë **nëpërmjet datës së maturimit që dëshironi:**
 - a. Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën () zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma që do të investohet në depozitë
 - b. Zgjidhni nga kalendari datën e maturimit të dëshiruar
 - c. Vendosni shumën (minimumi 50,000.00 ALL ose 500 monedhë e huaj)
 - d. Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it (nëse keni)
 - e. Interesi do të shfaqet automatikisht, **Klikoni** VAZHDO dhe në faqen konfirmuese **klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën.

Listën e normave të interesit dhe periudhave të hapjes së depozitave mund ta gjeni në linkun: [Buletini i Normave të Interesit | Banka Kombetare Tregtare \(bkt.com.al\)](https://www.bkt.com.al/Buletini_i_Normave_të_Interesit)

Kontrata e depozitës aktivizohet në moment kur biznesi është me të drejta të plota dhe në rast se ju keni të mirëmbajtur një adresë e-mail, ajo vjen automatikisht në adresën tuaj ose ju mund ta bëni share në kanale të tjera. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhesi i të dhëna dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet te shkojë tek Aprovime Në Pritje për të autorizuar Hapjen e Depozitës.

2. Historiku

Këtu do ju shfaqen të gjitha veprimet dhe transfertat e kryera.

Navigoni duke klikuar mbi llogarinë që doni dhe rrëshqisni lartë e poshtë që të shikoni veprimet

e kryera në llogarinë tuaj. Klikoni mbi butonin  Kërko nëse doni të kërkoni për një

transaksion të caktuar ose klikoni mbi këtë buton  për të filtruar transaksionet që doni të shihni dhe ndiqni hapat si më poshtë:

- a. Zgjidhni periudhën që doni duke klikuar mbi datën e fillimit dhe mbarimit dhe klikoni mbi Aplikoni, Vendosni shumën minimale dhe maksimale
- b. Zgjidhni llojin e transaksionit që doni të shikoni:
 - Në mbërritje, ▪ ose Veprimet e kryera me kartën e debitit
 - Në dalje,
- c. Zgjidhni monedhën dhe renditjen që doni dhe **klikoni** mbi Vazhdo
- d. Në faqen pasardhëse do ju shfaqen të gjitha transaksionet e kryera me kushtet e vendosura nga ju

Në historikun e transaksioneve përfshihen edhe Veprimet në Pritje, të cilat janë transaksione të kryera por ende të papërfunduara (psh: transfertëbrenda endit e kryer gjatë fundjavës apo një transaksion me kartë debiti). Këto veprime paraqiten në një seksion të dedikuar, bashkë me shumën totale të tyre.

VI. PAGESAT & TRANSFERTAT

Në këtë menu do të keni mundësinë të kryeni pagesa dhe transfertat të ndryshme. Me hapjen e parë të kësaj menu-je do ju shfaqet ikona e Kërko ku ju mund të kërkoni për përfituesit në listën tuaj ose të shtoni një përfitues të ri duke klikuar tek: "Shto përfitues të ri".

Plotësoni informacionin e përfituesit duke zgjedhur midis:

- **IBAN/ LLogaria BKT**
 - a. Vendosni emrin e përfituesit
 - b. Vendosni kodin IBAN/ numrin e Llogarisë në BKT, e më pas VAZHDO

Nëse klikoni tek Menu **Pagesat & Transfertat** do ju shfaqen 5 nënmenu:



- Transferta
- Pagesa
- Fatura
- Këmbim valute
- Miratimet në pritje
- **Pa kartë**



1. Transfertat

1.1 Midis llogarive të mia

Këtu mund të kryhen transferta mes llogarive që keni në BKT, brenda së njëjtës monedhë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:


- Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën () dhe duke **rrëshqitur poshtë/ lart**, zgjidhni llogarinë dërguese nga e cila do të kryhet transferta
- Vendosni shumën që do të transferohet
- Shkruani përshkrimin e transfertës (opsionale, pa karaktere speciale)
- Data e transfertës do të plotësohet automatikisht  Sot
- Klikoni** Vazhdo për të kryer transfertën
- Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgoni mandatin në adresën e postës elektronike,
- Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën
- Më pas mund të zgjidhni nëse:
 - Do të kryeni një transfertë të re
 - Apo të ktheheni tek Faqja kryesore

Transfertat mes llogarive janë aktive që në momentin e kryerjes, kur Biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhesi i të dhëna dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Aprovime Në Pritje për të autorizuar transfertën.

1.2 Brenda BKT

Këtu mund të kryeni transferta ndërmjet llogarive të hapura në BKT për çdo klient të BKT, në të njëjtën monedhë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm: Klikoni tek "Shto përfitues të ri" Plotësoni informacionin e përfituesit duke zgjedhur midis:

- **IBAN/LLogaria BKT**
 - a. Vendosni emrin e përfituesit dhe Plotësoni Emërtimin (opsionale)
 - b. Vendosni kodin IBAN e përfituesit brenda BKT, brenda vendit ose numrin e Llogarisë në BKT dhe klikoni VAZHDO
 - c. Në faqen pasardhëse plotësoni adresën e përfituesit dhe plotësoni:
 - Rrugën/ qytetin/ kodin postar; Numrin e telefonit
 - Zgjidhni shtetin e përfituesit
 - d. Më pas do ju shfaqen detajet bankare të përfituesit, **Klikoni** VAZHDO
 - e. Do ju shfaqet mesazhi i konfirmimit të përfituesit
 - f. Zgjidhni nëse doni të kryeni një transfertë tek ky përfitues ose nëse doni të ktheheni mbrapa tek Pagesat dhe Transfertat
 - g. Për të kryer transfertën plotësoni detajet e saj duke zgjedhur llogarinë tuaj nga e cila doni të kryeni transfertën, Vendosni shumën dhe Plotësoni detajet
 - h. Plotësoni numrin e telefonit të përfituesit (opsionale)
 - i. Data e transfertës do të plotësohet automatikisht me datën ku kryhet transfertat,
 - j. Klikoni VAZHDO dhe Në faqen konfirmuese, **klikoni** KONFIRMO
 - k. Më pas do ju shfaqet mesazhi i konfirmimit të transfertës



Shënim: Klikoni mbi ikonën për skanim dhe Skanoni kodin IBAN ose ngarkoni një imazh ku kodi IBAN shfaqet qartë për të shmangur vendosjen manuale të tij.

Transfertat brenda BKT janë aktive që në momentin e kryerjes, kur biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhësi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek [Aprovime Në Pritje për të autorizuar transfertën. Kushtet-e-Punes-Biznes Jan-2025.pdf](#)

1.3 Brenda Vendit


Këtu mund të kryeni transfertat nga llogaritë tuaja drejt një llogarie tjetër të hapur në një bankë tjetër të nivelit të dytë në Shqipëri. *Për këtë trasfertë duhet të zotëroni kodin IBAN të llogarisë pritëse.*

Në hapin e parë do t'ju shfaqet opsioni për të përzgjedhur nëse doni të përdorni të dhënat e një përfituesi të regjistruar, të shtoni një përfitues të ri ose të Klikoni "Transfertë e re" për të kryer një transfertë të re pa qene e nevojshme të regjistroni fillimisht përfituesin e fondeve.

Për të kryer këtë transfertë, ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Vendosni Emrin, Mbiemrin, IBAN, **Qytetin dhe Shtetin e përfituesit** dhe Klikoni VAZHDO
- Klikoni mbi llogarinë dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart, zgjidhni llogarinë dërguese nga e cila do të kryeni transfertën; Vendosni shumën që do të transferohet
- Përcaktoni monedhën e transfertës duke përzgjedhur nga lista
- Shkruani përshkrimin e transfertës (pa karaktere speciale)
- Vendosni numrin e telefonit të përfituesit (opsionale) dhe Klikoni VAZHDO
- Në faqen e konfirmimit të transfertës zgjidhni nëse tarifat do të paguhet nga:
 - Ju;
 - Përfituesi, apo

- Të përbashkëta (Shënim: Për transfertat në monedhën Lek ose Euro duhet të zgjidhni që tarifën e paguhen nga opsioni: Të përbashkëta)
- Zgjidhni nëse dëshironi të ruani përfituesin ose jo;
- Verifiko të dhënat e transaksionit dhe Klikoni KONFIRMO



Shënim: Klikoni mbi ikonën për skanim dhe Skano IBAN-in ose ngarko një imazh ku IBAN-i shfaqet qartë për të shmangur vendosjen manuale të tij.


Transfertat brenda Vendit bëhen aktive bazuar në kushtet e punës të publikuara në faqen zyrtare të BKT seksioni H Transferta në nisje për banka të tjera brenda vendit: [Kushtet-e-Punes-Biznes_Jan-2025.pdf](#)

1.4 Jashtë vendit, Transferta ndërkombëtare


Menuja e transfertave ndërkombëtare shfaqet vetëm nëse ju keni të autorizuar pajisjen ku po kryeni këtë veprim. Këtu ju mund të kryeni transfertat nga llogaria juaj drejt një llogarie tjetër të hapur në një bankë jashtë Shqipërisë. Për këtë transfertë duhet të keni kodin IBAN të llogarisë pritësi dhe kodin SWIFT të bankës pritëse dhe ndoqni hapat e mëposhtme:

Zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme:

1. **Tranfertë e Re**, kur tranferta po kryhet për herë të parë në një numër llogarie
2. **Përfitues i ri**, këtu ju mund të shtoni një përfitues të ri:
3. **Përfitues i regjistruar**, kur në të njëjtin numër IBAN është kryer më parë një transfertë.



Këtu mund të kryeni një transfertë ndërkombëtare të re




Këtu ju mund të shtoni një përfitues të ri

Këtu ju mund të shikoni listën e përfituesëve dhe mund të kërkoni një nga përfituesit e regjistruar.

Nëse keni zgjedhur **Transfertë e Re**:

- Zgjidhni tipin e transfertës:



Plotësoni të dhënat e transfertës

Këtu mund të Skanoni kodin IBAN ose të ngarkoni një imazh ku kodin IBAN shfaqet qartë për mos ta vendosur manualisht

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me **IBAN:**

- Plotësoni Emrin, Mbiemrin dhe kodin IBAN të përfituesit
- Plotësoni të dhënat e përfituesit:
 - Rruga- Adresa e vendbanimit; Qyteti - Qyteti i përfituesit
 - Kodi Postar - Numri i kodit postar, Numri telefonit të personit të llogarisë përfituese
 - Shteti - Zgjidhni nga lista shtetin e përfituesit dhe kliko Vazhdo
- Automatikisht do të plotësohet Shteti, Emri dhe kodi SWIFT i Bankës Pritëse
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transferata.
- Plotësoni shumën që doni të transferoni dhe Zgjidhni monedhën e transfertës
- Vendosni përshkrimin e transfertës bazuar në dokumentacinin justifikues dhe plotëso numrin e telefonit të përfituesit.
- Zgjidhni kategorinë e qëllimit të transfertës dhe Zgjidhni qëllimin e transfertës, i cili duhet të jetë në përputhje me aktivitetin e shoqërisë
- Zgjidhni kategorinë e klientit përfitues
- Nëse kemi limit overdrafti transferata do të merret nga ky limit
- Klikoni Aprovo, pasi të keni lexuar kushtet dhe termat për të vazhduar me transfertën dhe më pas VAZHDO, Shtoni dokumentin justifikues të transfertës duke klikuar ZGHIDH
- Zgjidh Tipin e dokumentit (Faturë Pro Farma, Faturë me TVSH, Kontratë, Akt Zhdoganimi)
- Klikoni VAZHDO për të vijuar me transfertën, Në faqen konfirmuese verifikoni të dhënat dhe zgjidhni se cili do të jetë personi që do të ngarkohet me pagesën e komisionit. Ju mund të zgjidhni një nga opsionet:
 - Nëse zgjidhni opsionin **Unë**, të gjitha detyrimet do i mbuloni ju
 - Nëse zgjidhni opsionin **Të përbashkëta**, detyrimet e bankës suaj i mbuloni vetë dhe përfituesi mbulon detyrimet e bankës së tij
 - Nëse zgjidhni opsionin **Përfituesi**, të gjitha detyrimet do t'i mbulojë pritësi
- Zgjidhni nëse do të regjistroni përfituesin për në vijim dhe klikoni Konfirmo
- Mandatin e transfertës mund ta gjeneroni/ ruani/ printoni ose ta dërgoni në adresën e postës suaj elektronike.

Shënim! Qëllimi i Transfertës duhet të jetë në përputhje me aktivitetin e shoqërisë.

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me **Emrin e Bankës Pritëse** (në këtë rast sigurohuni që të dhënat janë të sakta) dhe nëse keni kodin SWIFT të bankës përfituese:

- Plotësoni Emër, Mbiemër, Numrin e llogarisë së përfituesit dhe zgjidhni nga lista shtetin e përfituesit dhe klikoni VAZHDO. Plotësoni të dhënat e përfituesit:
 - Rruga - Adresa e vendbanimit; Qyteti- Qyteti i përfituesit
 - Kodi Postar - Numri i kodit postar, Numri telefonit të personit të llogarisë përfituese
 - Shteti - Zgjidhni nga lista shtetin e përfituesit dhe klikoni VAZHDO
- Klikoni VAZHDO dhe Plotësoni detajet e bankës së përfituesit:
 - Vendosni emrin dhe qytetin e Bankës Pritëse
 - Vendosni adresën dhe kodin SWIFT të Bankës Pritëse
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transferata. (Sigurohuni që llogaria e zgjedhur të ketë gjendje të mjaftueshme për shumën e transfertës)
- Plotësoni shumën që doni të transferoni dhe Zgjidhni monedhën e transfertës
- Vendosni përshkrimin e transfertës bazuar në dokumentacinin justifikues dhe plotëso numrin e telefonit të përfituesit.
- Zgjidhni kategorinë e qëllimit të transfertës dhe Zgjidhni qëllimin e transfertës, i cili duhet të jetë në përputhje me aktivitetin e shoqërisë
- Zgjidhni kategorinë e klientit përfitues
- Nëse kemi limit overdrafti transferata do të merret nga ky limit
- Klikoni Aprovo, pasi të keni lexuar kushtet dhe termat për të vazhduar me transfertën dhe më pas VAZHDO

- Shtoni dokumentin justifikues të transfertës duke klikuar "Zgjidh"
- Zgjidh Tipin e dokumentit (Faturë Pro Farma, Faturë me TVSH, Kontratë, Akt Zhdoganimi)
- Klikoni VAZHDO për të vijuar me transfertën dhe në faqen konfirmuese verifikoni të dhënat dhe zgjidhni se cili do të jetë personi që do të ngarkohet me pagesën e komisionit. Ju mund të zgjidhni një nga opsionet:
 - Nëse zgjidhni opsionin **Unë**, të gjitha detyrimet do i mbulonit ju
 - Nëse zgjidhni opsionin **Të përbashkëta**, detyrimet e bankës suaj i mbulonit vetë dhe përfituesi mbulon detyrimet e bankës së tij
 - Nëse zgjidhni opsionin **Përfituesi**, të gjitha detyrimet do t'i mbulojë pritësi
- Zgjidhni nëse do të regjistroni përfituesin për në vijim dhe klikoni Konfirmo
- Mandatin e transfertës mund ta gjeneroni/ ruani/ printoni ose ta dërgoni në adresën e postës suaj elektronike.

Nëse keni zgjedhur **përfituesin e ri**:

- **IBAN/** Llogaria BKT - Vendosni emrin e përfituesit - Këtu ju mund të shtoni një përfitues të ri Vendosni kodin IBAN/ numrin e Llogarisë në BKT, e më pas VAZHDO
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transferta
- Nëse doni të ndryshoni ndonjë informacion, vendosni informacionin e duhur.
- Zgjidhni se si do të kryhet pagesa e komisionit
- Klikoni Vazhdo për të përfunduar transfertën
- **Emër banke** - Vendosni emrin e përfituesit -Vendosni IBAN/ Llogarinë në BKT
- Zgjidhni shtetin e përfituesit duke rrëshqitur poshtë në listën e shteteve që do ju shfaqen, e më pas VAZHDO
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transferta
- Nëse doni të ndryshoni ndonjë informacion, vendosni informacionin e duhur.
- Zgjidhni se si do të kryhet pagesa e komisionit
- Klikoni VAZHDO për të përfunduar transfertën

Nëse keni zgjedhur **përfitues i regjistruar**:


- Zgjidhni nga lista njëren nga tranfertat dhe automatikisht do të shfaqen të dhënat e transfertës së regjistruar, Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transferta
- Nëse doni të ndryshoni ndonjë informacion, vendosni informacionin që doni.
- Zgjidhni se si do të kryhet pagesa e komisionit
- Klikoni VAZHDO për të përfunduar transfertën

Kujdes: Kërkesa për transfertë ndërkombëtare kalon për kontroll dokumentacioni dhe të dhënash në BKT. Pas kontrollit transferta aprovohet ose kthehet pas te klienti nëse ka të dhëna të gabuara/ mungesë dokumentacioni. Në rast se transferta është refuzuar ju duhet ta hidhni përseri nga e para, nëse është kërkuar dokumentacion apo përditësim të dhënash kryeni sistemimet dhe ridërgoni transfertën për aprovim. Dokumentacioni origjinal i ngarkuar në sistem duhet të paraqitet fizikisht në një nga degët e BKT nëse do të kërkohet nga banka.

1.5 Transfertat e mia Ndërkombëtare

Këtu do ju shfaqet lista e të gjitha transfertave ndërkombëtare të kryera nga kanalet online nga llogaritë tuaj të biznesit. Informacioni që mund të gjeni është:

- Numri i transfertës; Emri i përfituesit
- Shteti i bankës përfituese; shuma e transfertës
- Statusi i transfertës; data e regjistrimit të transfertës



Statuset e transfertës janë:

- Në proces - Transferta është kryer nga ju në BKT Smart dhe është dërguar për aprovim në BKT. Në këtë fazë ju keni mundësinë të anuloni transfertën nëse keni plotësuar diçka gabim. Nëse transferata është marrë në shqyrtim nga BKT ju nuk mund të anuloni veprimin.
- Përditëso të dhënat e transfertës - Ky status shfaqet pasi ju keni kërkuar anulimin e veprimit. Në këtë rast ju mund të kryeni veprimet e mëposhtme:
 - Modifiko Informacionin e Transfertës - ku do të shfaqet dritarja me të dhënat e transfertës dhe ju mund të bëni ndryshimet që doni,
 - Modifiko dokumentet bashkangjitur - mund të ngarkoni dokumentin e saktë justifikues përpara se transferata të kontrollohet,
 - Anullo Transfertën - anullo përfundimisht transfertën,
 - Dërgo për Verifikim - dërgoni për verifikim transfertën
- Kërkohe dokument - Transferta është kontrolluar nga specialisti i BKT dhe kërkohet të vendosen dokumentat e saktë për transfertën. Klikoni butonin "Shfaq Komentet" për të lexuar arsyen e kthimit të transfertës dhe më pas klikoni "Shto Dokument" për të ngarkuar dokumentin e saktë. Transferata do të kalojë përsëri në statusin "Në proces" për t'u rikontrolluar nga Specialisti i BKT në Degë/Drejtori
- Kërkohe dokument fizik - shfaqet pasi është aprovuar nga BKT por është i nevojshëm verifikimi i dokumentave
- Përfunduar me sukses - statusi merret në momentin që transferata është aprovuar nga sistemi i bankës. Në këtë faze mund të shkarkoni apo të dërgoni me email Mandatin si dhe të shkarkoni mesazhin Swift duke klikuar "Shkarko Mesazhin SWIFT".
- Refuzuar - tatusi merret në momentin që transferata është refuzuar nga banka pasi ka pasaktësi në të dhënat e transfertës
- Anulluar - statusi merret në momentin që transferata është anuluar nga vetë klienti

1.6 Në Fond Pensioni

Në këtë menu do të keni mundësinë të dërgoni kontribute tek fondi vullnetar i pensionit për kontratat individuale ose profesionale, për të dërguar fondet ndiqni hapat si mëposhtë:

- Zgjidhni një nga Shoqëritë Administruese të Fondeve të Pensionit (Sigal, Albsig)
- Zgjidhni llojin e kontratës Individuale ose Profesionale për të cilën po dërgoni fondet
- Plotësoni Numrin e Kontratës së fondit ose Numrin Personal të kartës së identitetit për të cilën po dërgoni fondet dhe Zgjidhni llogarinë nga e cila do të merren këto fonde,
- Përcaktoni shumën që doni të shtoni dhe vendosni një përshkrim, Klikoni VAZHDO
- Kontrolloni me kujdes të dhënat e pagesës në faqen konfirmuese, ku mund të zgjidhni nëse detajet e pagesës t'i dërgoni në adresën e postës tuaj elektronike
- Klikoni VAZHDO për të kryer transfertën.

1.7 E-Fatura

Këtu mund të kryeni pagesën e faturave të fiskalizuar për subjektin tuaj. Në këtë menu janë dhe dy nën menu:

a) Skano për të Validuar
Skanoni barcodin nëpërmjet kamerës së telefonit tuaj ku cilësohet "Të gjitha informacionet në lidhje me këtë faturë mund të shihen në këtë Kod QR"



Të gjitha informacionet në lidhje me këtë faturë mund të shihen në këtë Kod QR

Pasi të skanoni barcode duhet të shfaqet mesazhi nga faqja e DPTT Validimi i faturës u krye me sukses.

b) Skano për të Paguar;

Skano barcodin për te kryer pagesën e faturës së fiskalizuar ku cilësohet "Të gjitha informacionet e nevojshme për pagesën e kësaj fature mund të gjenden në këtë kod QR"

Pasi të skanoni barcode do të shfaqen fushat në vijim:

- Detajet (Nipt i shitësit, IBAN, Kodi i shitësit, NIVF, data e faturës, shuma e faturës);
- Automatikisht do të shfaqet IBAN i plotësuar në E-faturë, nëse dëshironi të plotësoni një IBAN tjetër apo përfituesi ka llogari në BKT, mjafton të fshini IBAN-in që shfaqet dhe plotësoni vlerën e re;
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet pagesa (sigurohuni që llogaria të ketë gjendje të mjaftueshme për pagesën) llogaria e zgjedhur mund të jetë dhe në monedhë të ndryshme nga fatura, në këtë rast veprimi kryhet me konvertim;
- Plotësoni shumën, ju mund të kryeni dhe pagesa pjesore por në asnjë rast nuk lejohet mbipagesa e faturës; Plotësoni përshkrimin e faturës dhe klikoni VAZHDO
- Në faqen tjetër do ju shfaqen detajet e pagesës, **Klikoni KONFIRMO** nëse konfirmoni detajet e shfaqura dhe më pas do ju shfaqet mesazhi i konfirmimit të pagesës;
- Zgjidhni nëse doni të kryeni një transfertë tek ky përfitues ose nëse doni të ktheheni mbrapa tek Pagesat dhe Transfertat

Kujdes: Nëse kompania është me nivel aprovimi, për të autorizuar pagesën, Autorizuesi duhet të shkojë tek Miratime në Pritje dhe të kryejë autorizimin.

2. Pagesat

Nëse klikoni menunë **Pagesat** do ju shfaqen 5 nënmenu. Ju mund të zgjidhni të kryeni pagesat për:

- Rimbushje Celulari
- Dogana
- Gjoha Trafiku
- Pagesë karte
- Taksat



2.1 Rimbushje celulari

Këtu mund të rimbushet një numër celulari me parapagesë për operatorët, One Albania dhe Vodafone Albania duke ndjekur hapat e mëposhtme:

- a. Zgjidhni operatorin e numrit celular që doni të rimbushni;

- b. Plotësoni numrin celular sipas formatit të kërkuar (nëse klikoni ikonën e kontakteve do të drejtoheni në listën e kontakteve tuaja dhe mund të zgjidhni numrin që doni të rimbushni nga kontaktet tuaja ;
- c. Më pas do ju shfaqen detajet e rimbushjes, si: Numri i celularit për rimbushje, llogaria nga e cila do të kryhet rimbushja, si dhe mundësia për të rimbushur nga shuma e përcaktuar ose mundësia e zgjedhjes së ofertave aktuale, **Klikoni VAZHDO**
- d. Zgjidhni shumën e rimbushjes, duke klikuar në kutinë përkatëse (ku do të renditen shumatat e paracaktuara të rimbushjes)
- e. Zgjidhni nëse doni të aktivizoni një ofertë për këtë operator tek Oferta aktuale dhe zgjidhni një nga ofertat/ paketat që doni,
- f. Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it, **Klikoni KONFIRMO**
- g. Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike.

Rimbushjet e telefonit celular janë aktive që në momentin e kryerjes, kur biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhësi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Miratime Në Pritje për të autorizuar rimbushjen.

2.2 Dogana

Këtu mund të paguani detyrimin që mund të keni ndaj doganës vetëm për subjektin tuaj:

- h. Plotësoni NIPT e subjektit dhe **Klikoni VAZHDO**:
 - **Klikoni** mbi llogarinë dhe duke **rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni llogarinë nga e cila doni të kryhet pagesa, Vendosni shumën
 - Plotësoni Përshkrimin (sipas dëshirës shkronja ose numra)
 - Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it dhe **Klikoni VAZHDO**
 - Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike

Pagesa e Doganës është aktive që në momentin e kryerjes, kur biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhësi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Miratime Në Pritje për të autorizuar pagesën e doganës.

2.3 Gjobat e trafikut

Këtu mund të paguhen gjobat e trafikut të cilat janë të regjistruara në sistemin e Drejtorisë së Policisë.

- **Regjistrimi i makinës**

Nëse nuk keni një makinë të regjistruar më parë atëherë:

- Plotësoni numrin e targës, Plotësoni numrin e shasisë
- Vendosni Emër Mbiemër dhe Plotësoni markën e makinës
- Klikoni tek Regjistrohu

- **Pagesë e re**

Zgjidhni informacionin për gjobën e trafikut:

- a. Me Numrin e gjobës - Vendosni numrin e gjobës (ku duhet të plotësohet numri i serisë së gjobës) dhe Klikoni VAZHDO për të kryer pagesën
- b. Me Informacionin e makinës - Vendosni numrin e targës dhe Vendosni numrin e shasisë (17 karaktere), më pas klikoni VAZHDO

Kërkimi mund të kryhet në 3 mënyra:

- Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni **Targa e mjetit** (ku duhet të plotësoni Numrin e Targës dhe numrin e Shasisë), **Klikoni** VAZHDO
 - Duke **rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni nga lista gjobën që doni të paguani
 - **Klikoni** mbi llogarinë dhe duke **rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni llogarinë nga e cila doni të kryhet pagesa, Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike
 - **Klikoni** ANULLO/ OK për të përfunduar ose anuluar kërkesën

- Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni **Numrin e Gjobës** (ku duhet të plotësohet numri i serisë së gjobës) dhe do të shfaqet vetëm gjoba me numrin e serisë përkatëse bashkë me statusin e paguar ose jo, nëse nuk është e paguar **Klikoni** VAZHDO ku do të shfaqen detajet e gjobës:
 - **Klikoni** VAZHDO dhe **Klikoni** mbi llogarinë, duke **rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni llogarinë nga e cila doni të kryhet pagesa,
 - Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it, **Klikoni** VAZHDO
 - Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike, **Klikoni** VAZHDO për të kryer pagesën

- Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni Targat e Mia (në rast se më parë nëpërmjet degës internet keni regjistruar targën tuaj), **Klikoni** VAZHDO
 - **Duke rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni nga lista gjobën që doni të paguani
 - **Klikoni** mbi llogarinë dhe duke **rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni llogarinë nga e cila doni të kryhet pagesa, në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike
 - **Klikoni** VAZHDO për të kryer pagesën

Pagesa e Gjobës është aktive që në momentin e kryerjes, kur biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhësi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Miratime Në Pritje për të autorizuar pagesën e Gjobës.

2.4 Pagesë karte

Për të parë **informacionin mbi kartat tuaja** të kreditit në BKT, ndiq hapat e mëposhtëm: Duke rrëshqitur majtas/ djathas, përzgjidh kartën për të cilën kërkohet informacioni dhe do të shfaqet informacioni i mëposhtëm:

- Mbajtësin e kartës (emër mbiemër) dhe Tipin e kartës së kreditit
- Numrin e kartës (për arsye sigurie shfaqet i koduar)
- Limitin e mbetur të kartës së kreditit
- Datën e prerjes së pasqyrës së llogarisë të fundit për kartën e kreditit
- Datën e fundit të pagesës për pasqyrën e fundit të llogarisë së kartës së kreditit
- Kryesore/ Dytësore (lloji i kartës), Limiti i kartës (limiti i aprovuar nga dega)
- Statusin e kartës (statusi i kartës së kreditit)

Për të paguar kartën tuaj të kreditit zgjidhni opsionin **Karta e zgjedhur**:

- **Klikoni** mbi kartën dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart, zgjidhni kartën për të cilën do kryhet pagesa, nëse keni një kartë klikoni mbi të dhe më pas do t'ju shfaqet:
 - Informacioni mbi kartën dhe Informacioni mbi detyrimin
- **Klikoni** mbi llogarinë dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet pagesa e kartës së zgjedhur dhe Zgjidhni tipin e pagesës:

- Nëse do të paguani shumën e mbetur (do të shfaqet automatikisht)
- Shumën minimale të mbetur (do të shfaqet automatikisht)
- Ose një shumë tjetër (duhet plotësuar manualisht)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it, klikoni VAZHDO
- Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike dhe Klikoni OK/ ANULLO për të përfunduar ose anuluar kërkesën

2.5 Taksat

Këtu ju mund të paguani detyrimet e taksave ndaj Institucioneve Buxhetore dhe Drejtorisë së Tatimeve.

2.5.1 Thesari

Nëpërmjet BKT Smart ju mund të paguani detyrimet e taksave ndaj institucioneve të ndryshme publike dhe Drejtorisë së Tatimeve. Mjafton të zgjidhni institucionin dhe të plotësoni detajet e pagesës me kodin e institucionit dhe kodin e llogarisë së thesarit:

- Zgjidhni institucionin për të cilin do të kryeni pagesën duke zgjedhur nga lista ose duke kërkuar me emrin ose kodin e institucionit,
- Vendosni kodin e llogarisë ekonomike për të cilën po kryeni pagesën
- Vendosni shumën e pagesës dhe Klikoni "Shto detyrimin".
- Për të shtuar një detyrim tjetër Klikoni "Shto një detyrim".
- Pasi të keni konfirmuar listën e detyrimeve të zgjedhura dhe shumën e detyrimeve Klikoni VAZHDO, Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet pagesa.
- **Plotësoni Numrin e faturës ose Skanoni barkodin e numrit të faturë për të shmangur vendosjen manuale të tij,**
- **Vendosni Numrin Identifikues të Veprimeve Financiare/ NIVF (opsionale).**
- Vendosni një përshkrim mbi pagesën që po kryeni dhe Klikoni VAZHDO.
- Verifikoni detajet e veprimit dhe Klikoni KONFIRMO për të përfunduar pagesën.

2.5.2 Tatimet

Për të kryer këtë pagesë duhet të jeni të pajisur me formularët e pagesave të TVSH, Tatim në Burim apo Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore, ndiqni hapat për të kryer pagesën:

- Plotësoni numrin serial duke përdorur një nga mënyrat e mëposhtme:
 - Duke plotësuar manualisht numrin, ose
 - Duke skanuar barkodin e faturës që doni të paguani
- Plotëso shumën e pagesës (shuma e shënuar në faturë)
- Vendosni përshkrimin për veprimin (opsionale) dhe Klikoni VAZHDO
- Klikoni KONFIRMO për të përfunduar pagesën

Të gjitha veprimet e mësipërme do kyhen automatikisht vetëm nëse biznesi ka kërkuar që përdoruesi të ketë të drejta të plota ndryshe do shfaqet mesazhi "Veprimi juaj u dërgua për miratim"

2.6 Pagesa e-Albania

Këtu ju mund të paguani të gjitha urdhër pagesat që keni gjeneruar nga profili juaj në platformën eAlbania:

Në platformën eAlbania, pasi të keni hyrë në platformën eAlbania:

- Zgjidhni Pagesa Online, ku do t'ju shfaqet lista e shërbimeve që mund të paguhet online
- Zgjidhni shërbimin që doni të paguani dhe Plotësoni të dhënat e kërkuara
- Zgjidhni tipin e pagesës "Pagesë Online", Verifikoni me kujdes të dhënat e plotësuara
- dhe për të vazhduar me hapin e rradhës Klikoni VIJO
- Zgjidhni E-banking dhe ikonën e BKT Smart nga lista:



- Më pas do t'ju shfaqen detajet e Bankës (Emri, adresa, nr i telefonit dhe kodi SWIFT i bankës), Klikoni "Gjenero urdhërpagesën"
- Konfirmoni nëse doni të vazhdoni pagesën me BKT duke klikuar PO
- Detajet e urdhërpagesës do t'ju shfaqen në ekran,
- Klikoni PRINTO nëse doni t'ju gjenerohet urdhërpagesa në format PDF

Në aplikacionin BKT Smart, Më pas hyni në BKT Smart dhe Klikoni Pagesa & Transferta:

- Klikoni nënmenunë eAlbania
- Zgjidhni një nga urdhër pagesat e gjeneruara nga platforma e eAlbania-s, nga lista e pagesave që do t'ju shfaqet dhe Klikoni PAGUAJ
- Konfirmoni të dhënat e pagesës nëse janë të sakta duke klikuar KONFIRMO
- Për të ruajtur ose shpërndarë mandatin e veprimit Klikoni Shpërndaje

Nëse doni të kryeni një pagesë të re Klikoni mbi "Pagesë e Re":


- Plotësoni numrin e urdhërpagesës dhe Klikoni VAZHDO
- Verifikoni me kujdes detajet e urdhërpagesës dhe nëse doni të kryeni pagesën Klikoni VAZHDO, Për të ruajtur ose shpërndarë mandatin e veprimit Klikoni Shpërndaje

Tashmë në bashkëpunim me **e-Albania** dhe **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)**, ju keni mundësi të kryeni **pagesën e taksës vjetore të mjeteve të përdorura dhe mjeteve të luksit** në mënyrë tërësisht elektronike nëpërmjet BKT Smart.

Të gjitha veprimet e mësipërme do kyhen automatikisht vetëm nëse biznesi ka kërkuar që përdoruesi të ketë të drejta të plota ndryshe do shfaqet mesazhi "Veprimi juaj u dërgua për miratim".

3. Fatura

3.1 Pagesë faturash

Klikoni tek "Pagesë e re" ose klikoni mbi këtë buton  për të skanuar faturën që doni të paguani. Zgjidhni Institucionin lëshues të faturës që doni të paguani dhe ndiqni hapat:

- Zgjidhni një nga kategoritë e listuara
- Automatikisht do të listohen Institucionet për kategorinë e zgjedhur,
- Zgjidhni Institucionin lëshues të faturës nga lista dhe vendosni kodin e klientit
- Klikoni VAZHDO,
- Zgjidhni faturën për të paguar
- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të bëhet pagesa, vendosni përshkrimin (opsionale)
- Data e veprimit do të plotësohet automatikisht me datën kur kryhet pagesa
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it, Klikoni VAZHDO
- Në faqen konfirmuese Konfirmoni pagesën e faturës



3.2 Faturat e autorizuar

Sapo të klikoni në këtë nënmenu do të drejtoheni në listën e Autorizimeve ekzistuese. Autorizimet janë marrëveshje që ju krijoni me Bankën për pagesën e faturave të institucioneve me të cilat BKT ka marrëveshje. Zgjidhni një nga ofruesit e shërbimeve dhe vendosni kodin e klientit, klikoni VAZHDO. Duke **klikuar** në njërën prej tyre do të mund ta modifikoni ose mbyllni atë si dhe të shihni detajet e tij si mëposhtë listuar:

- Statusi (statusi i kësaj marrëveshjeje, i hapur ose mbyllur)
- Tipi (tipi i marrëveshjes, nëse është pagesë manuale, automatike etj.)
- Data e fillimit (data e krijimit të kësaj marrëveshjeje), Dita e pagesës (data e zgjedhur nga klienti që të njoftohet ose kryhet pagesa automatike)
- Numri i Abonentin (dhënë nga Institucioni)
- Numri i Autorizimit (kodi i referencës së marrëveshjes nga BKT)
- Numri i llogarisë (llogaria nga e cila do të merret shuma e faturës)
- Institucioni (për të cilin është hapur marrëveshja)

Për të **mbyllur** marrëveshjen automatike të zgjedhur klikoni Konfirmoj se dëshiroj të mbyll marrëveshjen me detajet e mësipërme në fund të faqes dhe **Klikoni** APROVO

Klikoni butonin **Modifiko** për të modifikuar marrëveshjen e zgjedhur. Modifikimet që mund të kryhen janë:

- Llogaria nga ku doni të kryhet pagesa dhe Kohëzgjatja e autorizimit
- Tipi i pagesës dhe Data e pagesës

Pas modifikimeve të kryera **klikoni** VAZHDO për të konfirmuar ndryshimet dhe **klikoni** APROVO për të përfunduar kërkesën

Për të **krijuar** një autorizim të ri klikoni tek "Regjistro një autorizim të ri" dhe ndiqni hapat:

- Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni nga lista Institucionin për të cilin doni të krijoni një autorizim
- Vendosni të dhënat përkatëse sipas formatit të kërkuar dhe **Klikoni** VAZHDO
- Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni një llogari nga lista e llogarive tuaja në BKT, nga e cila do të merret pagesa e faturave
- Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni periudhën e autorizimit
 - **Pa limit** (s'ka një datë të caktuar për afatin e autorizimit)
 - **Me afat** (deri në periudhën e zgjedhur nga klienti, zgjedhja kryhet në bazë mujore)
- Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni Datën e pagesës (e cila është e vlefshme për pagesat automatike) dhe Duke **rrëshqitur lartë/ poshtë** zgjidhni tipin e pagesës:
 - **Automatike** (pagesë automatike), nëse doni që pagesa e faturave të kryhet automatikisht nga llogaria juaj çdo muaj
 - **Automatike e limituar** (pagesë automatike), nëse doni që pagesa e faturave të kryhet automatikisht nga llogaria juaj, deri në një shumë të zgjedhur nga ju
 - **Manuale**, nëse doni që pagesën ta kryeni personalisht nga BKT Smart
- Zgjidhni mënyrën e njoftimit
 - Njofto mbërritjen e faturës me email
 - Njofto pagesën e faturës me email
 - Njofto pagesën e faturës me SMS
- **Klikoni** VAZHDO dhe në faqen konfirmuese verifikoni edhe një herë të dhënat
- **Klikoni** Aprovo për të përfunduar ose anuluar kërkesën

3.3 Pagesë fature me Barkod

Këtu mund të paguani faturat të cilat kanë një Barkod duke e skanuar këtë kod:

- Klikoni mbi këtë buton  Lejoni BKT Smart të ketë akses për foto ose video

- Drejtoni zonën e skanimit mbi Barkodin në faturë dhe automatikisht do të shfaqet informacioni për këtë faturë
- Duke **rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni llogarinë nga e cila do të merret pagesa e shumës
- Vendosni përshkrimin (opsionale) **Klikoni** VAZHDO për të kryer pagesën
- Në faqen konfirmuese konfirmoni veprimin tuaj

Pagesa e faturës kryhet automatikisht, nëse biznesi ka kërkuar që përdoruesi të ketë të drejta të plota, nëse kompania është me nivele aprovimi, autorizuesi duhet të shkojë te Miratime në një pritje për të kryer autorizimin e pagesës.

4.Këmbim Valute

Nëse **klikoni** në këtë menu do ju shfaqen **4 nënmenu:**

- Këmbimi valutor
- Bli valutë të huaj
- Shit valutë të huaj
- Konverto në valutë të huaj
- Kërkesat e mia



4.1 Këmbimi valutor

Nëse **klikoni** tek ky opsion do ju shfaqet:

- Kursi në ALL (këtu mund të shikoni kursin e këmbimit valutor vetëm për monedhën Lekë)
- Kurse të tjera (këtu do ju shfaqet informacioni mbi kurse të tjera valutore)
- Llogarit (këtu mund të llogarisni këmbimin valutor) - Zgjidhni monedhat që doni të këmbeni dhe do ju shfaqet kursi i këmbimit valutor

4.1.1 Bli valutë të huaj

Për të Blerë Monedhë të Huaj klikoni mbi "Bli valutë të huaj" dhe ndiqni hapat e mëposhtme:

- Zgjidhni monedhën për të blerë duke zgjedhur një nga monedhat e listuara ose kërkonte për monedhën që doni dhe zgjidhni llogarinë nga e cila doni të bëni këmbimin
- Zgjidhni llogarinë tek e cila do të kryhet veprimi dhe Vendosni shumën
- Plotësoni detajet (opsionale) dhe **Klikoni** VAZHDO
- Në faqen konfirmuese konfirmoni veprimin tuaj duke **klikuar** KONFIRMO

4.1.2 Shit valutë të huaj

Për të Shitur Monedhë të Huaj klikoni mbi "Shit valutë të huaj" dhe ndiqni hapat:

- Zgjidhni monedhën për të blerë duke zgjedhur një nga monedhat e listuara ose kërkoni për monedhën që doni dhe Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të bëni këmbimin
- Zgjidhni llogarinë tek e cila do të bëhet veprimi dhe Vendosni shumën
- Plotësoni detajet dhe **Klikoni** VAZHDO,
- Konfirmoni veprimin duke klikuar KONFIRMO në faqen konfirmuese

4.1.3 Konverto në valutë të huaj

- Zgjidhni monedhën për të blerë duke zgjedhur një nga monedhat e listuara ose kërkoni për monedhën që doni dhe Zgjidhni monedhën e shitjes duke zgjedhur një nga monedhat e listuara ose kërkoni për monedhën që doni
- Vendosni shumën dhe Plotësoni detajet e përshkrimit
- **Klikoni** VAZHDO dhe më pas KONFIRMO për të përfunduar këmbimin

Sipas përzgjedhjes shumat e konvertuara automatikisht kalojnë në gjendje në llogaritë e përzgjedhura, kur biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhësi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Miratime në Pritje për të autorizuar veprimin.

4.2 Kërkesat e mia

Në menunë "Kërkesat e mia" ju mund të kontrolloni statusin e kërkesës për kurs këmbimi preferencial dhe gjithashtu keni mundësi të anuloni Kërkesën apo të përfundoni veprimin për këmbim valutor preferencial. Për të **anulluar kërkesën** zgjidhni kërkesën dhe klikoni ANULLO.

Statusi i kërkesës pasi të jetë konfirmuar nga BKT është ndryshuar në "Konfirmuar". **Për të përfunduar veprimin** klikoni APROVO:

- Në ekranin "Detajet e këmbimit" do të shfaqen automatikisht:
 - Llogaria debituese dhe kredituese e zgjedhur më parë dhe Shuma për këmbim
- Klikoni VAZHDO dhe në ekranin konfirmues klikoni KONFIRMO.

Shënim: Vlera e shumës për këmbim nga ana juaj mund të ndryshohet +/- 20% nga shuma fillestare për klientet biznes, por në të gjitha rastet shuma nuk duhet të jetë më e ulët se 10,000 Euro ose ekuivalenti në monedha të tjera.

Pasi BKT të aprovojë kursin preferencial, **konfirmimi i dërgohet përdoruesit** që ka kryer veprimin, kur biznesi ka të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhësi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Miratime në Pritje për të autorizuar veprimin.

5. Miratime në pritje

Në këtë menu do të shfaqen të gjitha veprimet që duhet të autorizohen nga përdoruesi i kanaleve online i cili ka të drejta aprovimi. **Klikoni** menunë Miratime në pritje dhe zgjidhni veprimin që do të aprovonit, zgjidhni **APROVO** ose **REFUZO** veprimin

- Nëse keni zgjedhur APROVO, transaksioni do të kryhet me sukses,
- Nëse keni zgjedhur REFUZO transaksioni do të anulohet.

6. Pa kartë

Kjo menu do të përdoret në rastet kur ju doni të depozitoni para në ATM në llogarinë e biznesit pa patur nevojën e kartës tuaj të lëshuar nga BKT në momentin e kryerjes së transaksionit. Depozitimi do të jetë i vlefshme vetëm në SMART BanKomaT.

6.1 Depozitim me Kod Unik

Këtu do ju shfaqet mundësia e depozitimit pa kartë nëpërmjet Kodit Unik. Ju mund të krijoni një veprim në rast se nuk keni kartën prezent duke ndjekur hapat e mëposhtme:

- Klikoni Pagesa "Pa kartë", "Depozitim me Kod Unik" dhe Krijoni një "Gjenero Kod unik"
- Zgjidhni llogarinë në të cilën doni të kryeni depozitimin
- Zgjidhni emrin e punonjësit që do të kryejë depozitimin në ATM
- Zgjidhni burimin e të ardhurave nga lista dhe Zgjidhni nëse doni të depozitoni në një ATM të caktuar apo në të gjithë rrjetin e ATM SMART BankKomaT të BKT
- Zgjidhni kohën për të cilën do të jetë aktive kodi unik (nga 1-72 orë) dhe Klikoni VAZHDO
- Automatikisht me marrjen e konfirmimit të veprimit do të gjenerohet një kod, i cili do të vendoset në ATM, si identifikim për të kryer depozitimin në ATM (ky kod do t'i dërgohet me sms punonjësit që do të kryejë depozitimin).

Me marrjen e kodit me një përdorim punonjësi paraqitet në SMART BankKomaT dhe ndjek hapat:

- Zgjidhni Menunë "Transaksione pa kartë" dhe "Depozitim me Kod Unik"
- Vendos kodin me një përdorim në ATM dhe Klikoni KONFIRMO, Depozitoni fondet në ATM,
- Në ekranin e faturës do ju jepet mundësia të printoni ose jo faturën
- Më pas ATM do të japi shumën e depozituar nga ju duke finalizuar veprimin

6.2 Depozitimet e mia pa kartë

Këtu mund të verifikoni veprimet e krijuara më parë në bazë të statusit (duke i filtruar):

- Anulluar
- Përfunduar
- Skaduar

Ju mund të kërkoni për një depozitim të caktuar duke klikuar "Filtro", duke zgjedhur periudhën kohore dhe duke zgjedhur rangun e shumës që doni. Ju mund të anuloni veprimet e vlefshme të cilat ende nuk janë përdorur duke klikuar ANULLO dhe duke konfirmuar veprimin e anulimit.

VII. PRODUKTET DHE SHËRBIMET

1. PRODUKTET

Nëse klikoni në këtë menu do ju shfaqet nënmenutë:

- Hapni një llogari
 - Shto një llogari rrjedhëse
- Hapni një depozitë
 - Nëpërmjet listës së produkteve
 - Nëpërmjet datës së maturimit
- Prano Pagesat e Faturave Tatimore
 - Cilësimet
 - Veprimet

1.1 Hapni një llogari rrjedhëse

Për të shtuar një llogari të re rrjedhëse klikoni tek ikona e "Hapni një llogari rrjedhëse" dhe zgjidhni një nga monedhat e mëposhtme për llogarinë tuaj:

- Lekë (ALL)
 - Euro(EUR)
 - Dollar Australian (AUD)
 - Paund Britanik (GBP)
 - Dollar Kanadez (CAD)
 - Dollar Amerikan (USD)
 - Franga Zviceriane (CHF)
- Pasi të keni zgjedhur monedhën që doni, plotësoni Emrin e llogarisë
 - Zgjidhni logon e llogarisë dhe **Klikoni VAZHDO**




- Konfirmoni llogarinë tuaj me të dhënat duke **klikuar** KONFIRMO

Llogaria rrjedhëse është aktive që në momentin e hapjes kur Biznesi është me të drejta të plota. Kur biznesi ka zgjedhur alternativën që hedhësi i të dhënave dhe aprovuesi të jenë të ndryshëm, atëherë aprovuesi duhet të shkojë tek Miratime në Pritje për të autorizuar hapjen e llogarisë.

1.2 Hapni një depozitë

Për të shtuar një depozitë të re klikoni Hapni një depozitë:

- Duke **klikuar** majtas/ djathtas zgjidhni mënyrën e hapjes së depozitës:
 - Nëpërmjet listës së produkteve të BKT (me periudha fikse)
 - Nëpërmjet Datës së maturitetit që doni (minimumi i periudhës së hapjes së depozitës është 40 ditë)
- Nëse keni zgjedhur të hapni depozitë **sipas produkteve të BKT**
 - o Duke **rrëshqitur poshtë/ lartë** zgjidhni tipin e depozitës nga lista
 - o Duke **klikuar** mbi llogarinë ose shigjetën () zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma që do të investohet në depozitë
 - o Vendosni shumën (minimumi 50,000.00 ALL ose 500 monedhë e huaj)
 - o Interesi do të shfaqet automatikisht dhe zgjidhni nëse doni që kjo depozitë të rinovohet automatikisht apo jo
 - o Nëse po zgjidhni tipin e rinovimit (Principal ose Principal & Interes)
 - o **Klikoni** VAZHDO dhe në faqen konfirmuese **klikoni** OK/ ANULLO për të përfunduar ose anuluar vprimin
- Nëse keni zgjedhur të hapni depozitë **nëpërmjet datës së maturimit që dëshiron** ndiqni hapat e mëposhtme:
 - o Zgjidhni nga kalendari datën e maturimit të dëshiruar
 - o Vendosni shumën (minimumi 50,000.00 ALL ose 500 monedhë e huaj)
 - o Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it (nëse keni)
 - o Interesi do të shfaqet automatikisht, **Klikoni** VAZHDO
 - o Në faqen konfirmuese **klikoni** OK/ ANULLO për të përfunduar ose anuluar veprimin

Listën e normave të interesit dhe periudhave të hapjes së depozitave mund ta gjeni në linkun: [Buletini i Normave të Interesit | Banka Kombetare Tregtare](#)

1.3 Prano Pagesat e Faturave Tatimore dhe Smart POS

1.3.1 Cilësimet

Në këtë menu biznesi thjeshtëson procesin e pagesës së faturave në cash nga klientët individ përkundrejt klientëve të biznesit. Ju do të keni mundësi të grumbulloni pagesat e faturave (të lëshuara nga kasa) direkt në llogarinë tuaj nëpërmjet BKT Smart, në momentin e pagesës do të dërgohen njoftime automatike në platformën tuaj financiare ndryshuar statusin e faturave në "Fatura të Paguara". Pas njoftimit automatik nuk do të keni nevojë të kryeni veprime të tjera manuale për të kryer ngarkimin e faturave të arkëtuara në sistem.


1.3.2 Aktivizimi i shërbimit

Zgjidhni menunë "Prano pagesat e faturave" dhe më pas **FILLO**, Lexoni termat dhe kushtet e shërbimit dhe klikoni **VAZHDO**, zgjidhni **Cilësimet** dhe më pas një nga mënyrat e pagesës:

○ **Përfito të gjitha pagesat në një Iban**

- ku të gjitha pagesat do të grumbullohen në të njëjtën llogari, Zgjidhni llogarinë në të cilën do të grumbullohen fondet:

- Zgjidhni nëse do të aktivizoni ose jo njoftimin nga palët e treta,
- Klikoni PËRFUNDO, e automatikisht do të gjenerohet kodi unik i biznesit i cili do të përdoret për aktivizimin e Smart POS



○ **Përfito të gjitha pagesat sipas kodit të biznesit** - ku pagesat do të grumbullohen sipas llogarive të zgjedhura për çdo kod biznesi:

- **Klikoni "+"** shto kodin e biznesit
- **Plotësoni** kodin e njësisë së biznesit të regjistruar te DPT për të identifikuar kasat
- Zgjidhni llogarinë në të cilën do të grumbullohen fondet
- Zgjidhni nëse do të aktivizoni apo jo njoftimin nga palët e treta
- Klikoni Shto kodin e biznesit dhe më pas PËRFUNDO

○ **Asnjë** - Nëse nuk dëshironi më shërbimin duhet të klikoni Cilësime dhe te mënyra e pagesës zgjidhni "Asnjë" e më pas PËRFUNDO për të çaktivizuar shërbimin.

Në link gjeni video tutorial për: [Si të pranojmë pagesat e faturave nëpërmjet BKT Smart?](#)

1.3.3 Smart POS

Smart POS është një version dixhital i POS-it tradicional që përdoret nga biznesi për të grumbulluar pagesat nëpërmjet skanimit të kodit QR të gjeneruar në BKT Smart. Punonjësi i biznesit direkt nga BKT Smart mund të krijojë një kod QR në shumën e faturës për tu paguar nga klienti individ.

Për të aktivizuar Smart POS, përcaktoni një nga mënyrat e pagesës në pikën 1.3. Pas aktivizimit do të krijohet në Pre-login menuja e re Smart POS.

- Punonjësi që do të bëj konfigurimin e kasës virtuale, e cila do të përdoret për Smart POS, duhet të jetë i pajisur me Kodin Unik dhe NIPT nga administratori i subjektit i cili ka aktivizuar shërbimin.
- Më pas **Klikoni** Shto kasë "+" dhe **plotësoni** NIPT-in dhe Kodin Unik
- **Klikoni** KRIJO dhe automatikisht do të shtohet Kasa Virtuale
- Klikoni Kasën Virtuale për të gjenuar kodin QR për pagesë, dhe **vendosni** shumën
- **Klikoni** KONFIRMO, do të gjenerohet kodi QR i cili është gati për pagesë
- Klienti mund të skanoj kodin QR direkt nga telefoni i punonjësit ose punonjësi mund ta

shpërndaj te klienti nëpërmjet butonit



Në link gjeni video tutorial për: [Si të aktivizojmë shërbimin Smart POS në BKT Smart?](#)

1.3.4 Pagesa nga Smart Pay

Pagesa e faturës do të kryhet nga klienti nëpërmjet skanimit të kodit QR në Smart Pay.

- **Hyni** në Smart Pay duke vendosur kredencialet tuaja, **Klikoni** mbi "Skano Kodin QR":
 - Nëse pagesa do të bëhet me faturë fizike klienti duhet të vendosi brenda kornizës kodin QR të faturës fizike.

- Nëse pagesa do të kryhet me kodin QR të gjenruar nga Smart POS klienti duhet të vendosi brenda kornizës QR kodin e gjenruar nga punonjësi.
- **Konfirmoni** Detajet e transfertës me QR, **Zgjidhni** llogarinë nga e cila do të kryhet pagesa
- **Klikoni** VAZHDO dhe veprimi do të kryhet me sukses

Në link gjeni video tutorial për: [Si të kryejmë pagesat e faturave dhe pagesat me skanim QR Kod nëpërmjet BKT Smart Pay?](#)


1.3.5 Veprimet e kryera

Në këtë menu mund të shikoni listën e veprimeve të kryera nëpërmjet kodit QR dhe shumën e veprimive




1.3.6 Verifikimi i faturave të paguara

Për të verifikuar nëse një faturë është e paguar apo jo hyni në menunë Smart POS, zgjidhni menunë Skano për të vërtetuar dhe Skanoni kodin QR të faturës duke e vendosur kodin brenda kornizës, automatikisht do të shfaqet informacioni nëse fatura është e paguar apo jo.



Klikoni këtu për të skanuar QR kodin



2. SHËRBIMET

Nëse Klikoni në këtë menu do ju shfaqen:


- 1- Aprovimet e mia, ku mund të shihni dokumentat që ju keni aprovuar, aprovimet e blerjeve me kartë në tregtarë me opsionin e sigurisë 3D dhe detajet e aprovimeve në çdo kohë
- 2- ATM më e afërt (për të përdorur këtë menu duhet të aktivizoni Vendndodhjen/ Location), ku mund të gjeni vendndodhjen e ATM-ve më të afërta. Kontrolloni në hartë për të gjetur ATM më të afërt me pozicionin tuaj ose klikoni listën për të parë listën e të gjitha ATM-ve më të afërta dhe distancën nga pozicioni juaj
- 3- Llogaritësi, ku do të shfaqet Llogaritësi i Depozitës apo Llogaritësi i Kredisë, klikoni një nga opsionet për të marrë informacionin
- 4- Bileta në rradhë (për të përdorur këtë menu duhet të aktivizoni Vendndodhjen/ Location), ku mund të rezervoni rradhën për në degët e BKT. Klikoni këtë menu dhe do ju shfaqet lista e biletave që ju keni ose klikoni "Merrni Biletë" për të marrë një biletë të re.

VIII. DALJA NGA BKT SMART

Për të dalë jashtë nga BKT Smart klikoni tek menu-ja **Profili & Cilësimet**

Kikoni butonin "Dil". Konfirmoni veprimin e daljes duke klikuar tek "Dil" në mesazhin e konfirmimit.

Klikoni këtu për të dalë nga aplikacioni BKT Smart



IX. PROÇESI I MBYLLJES SË BKT SMART

Në rast se nuk doni të përdorni më aplikacionin e BKT Smart:

1. Duhet të ç'instaloni aplikacionin e BKT Smart nga aparati juaj celular
2. Duhet të kontaktoni me shërbimin e klientit ose me degën tuaj, për të bllokuar përdorimin për këtë kanal

X. PROÇESI I RIAKTIVIZIMIT TË PËRDORIMIT TË BKT SMART

Në rast se është kryer më parë kërkesa për bllokim të përdorimit të BKT Smart dhe dëshiron ta përdorësh përsëri aplikacionin, duhet të kontaktolesh me shërbimin e Call Center ose me degën tënde, për tu informuar për hapat e nevojshme që duhen ndjekur.

Për më shumë informacion dhe për çdo paqartësi që mund të keni, ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni në numrin e telefonit të shërbimit të Call Center +35542266288, shërbim ky 24 orë në 7 ditë